



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Ekonomist në Sektorin e Informatikës dhe Statistikës pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Ekonomisë;
- Nota mesatare do të jetë avantazh;
- Eksperienca në punë do të jetë avantazh;
- Të zotërojë kompjuterin;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier, **brenda datës 30.06.2022**, këto dokumenta;

- Kërkesë për punësim;
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (Curriculum Vitae);
- Diplomë e Arsimit të Lartë;
- Diplomë Master;
- Listë notash;
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Çertifikatë kompjuteri;

- Çertifikatë familjare;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Librezën e punës;
- Kartë identitetit (Fotokopje);
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajëve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë (të datojë brenda 3 muajëve të fundit).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet në sekretari.

Adresa: Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier, Lagjia “1 Maji”, Rruga “Jani Bakalli” Tel 034 222145.